

UDHËZIM
Nr. 38, datë 26.12.2018

PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE
2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2019, të jenë:

- | | |
|------------------------------|------------------|
| a) Gjuhë e huaj: | 7 qershor 2019; |
| b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: | 12 qershor 2019; |
| c) Matematikë: | 17 qershor 2019; |
| d) Provimi me zgjedhje: | 24 qershor 2019. |

2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, miratuar me urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, të përcaktojnë testin për secilin provim të Maturës Shtetërore.

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019:

4.1 Fillojnë në orën 10:00.

4.2 Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.

4.3 Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.

4.4 Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.

4.5 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, rrijapin provimet në sesionin e dytë.

5. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018–2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, t’i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura on-line, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

5.1 Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

5.2 Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, “Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë”.

5.3 Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

5.4 Testi i provimit “Gjuhë frënge” (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

5.5 Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit paketohen për çdo qendër më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.

5.6 Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2019 zhvillohen në qendrat e provimeve të

përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla